# DËSHMI ARKIVI

**A-468074**
VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | E reja e akuzon për drogim dhe përdhunim, influenceri i njohur rrezikon 20 vite burg! \| Top Albania Radio |
| ADRESA | `https://www.topalbaniaradio.com/e-reja-e-akuzon-per-drogim-dhe-perdhunim-influenceri-i-njohur-rrezikon-20-vite-burg/` |
| BURIMI | topalbaniaradio.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 25 shtator 2026, 08:37:11 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 25 shtator 2026, 08:29:02 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `026ab28983fa86ca938527bc1b3334b5f28e9d61ba7a37b47d4424117187ef6d` |
| TEKSTI | `968a13a1ee6e510d592aad7b391d8e9e98ba3059a51e0305c06e302bd9551b3c` |
| PAMJA | `a58bcdac6dc606b5528837a085e2c1034824307105b63abab61c3b1914065410` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `ffbd428d54280bcd2a0ccaee65a854aba6e17768499e8ff55603e8011bdceac0` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `8b8efb9319bb60e287a9053a50eed732645594d6e8c6608cdfe651dfbc0b1533` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/ffbd428d54280bcd2a0ccaee65a854aba6e17768499e8ff55603e8011bdceac0`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Bota

# E reja e akuzon për drogim dhe përdhunim, influenceri i njohur rrezikon 20 vite burg!

*Marisa Karabeci*

*25 Shtator 2026*




Influencuesi kontrovers i rrjeteve sociale i njohur me pseudonimin Clavicular, emri i vërtetë Braden Peters, është përballur me akuza të rënda penale në SHBA. Ai akuzohet nga një 17-vjeçare për drogim për qëllime seksuale dhe për përdhunim. Sipas dokumenteve gjyqësore të cituara nga mediat amerikane, 20-vjeçari dyshohet se e ftoi vajzën në shtëpinë e familjes së tij në Cape Cod, Massachusetts, ku më pas i dha sasi të mëdha vodka gjatë një transmetimi live.

Vajza, Aleksandra Vasilevna Mendoza, pretendon se Peters i kishte premtuar se do t'a ndihmonte të bëhej “fytyra femërore e looksmaxxing”, nëse ajo pranonte të merrte pjesë në një livestream me të. Sipas padisë civile, të dy kishin qenë në kontakt prej rreth një viti dhe ishin njohur kur Mendoza ishte 16 vjeç. Gjatë transmetimit, Peters dyshohet se i ka dhënë alkool në sasi të mëdha. Mendoza ka deklaruar para policisë se gotat me vodka ishin “më shumë si gota të plota”, ndërsa ajo e përshkruan veten si person që nuk e përballon lehtë alkoolin.

Dokumentet pretendojnë gjithashtu se Peters u tha shikuesve se vajza ishte 18 vjeç dhe se ata po pinin ujë, në mënyrë që të anashkalonin kufizimet e Twitch për alkoolin. Pas përfundimit të transmetimit, Mendoza pretendon se u dërgua në një dhomë gjumi dhe se pati marrëdhënie seksuale me Peters ndërsa ishte tepër e dehur për të dhënë pëlqimin. Ajo pretendon gjithashtu se të nesërmen në mëngjes u sulmua seksualisht përsëri ndërsa ishte në gjumë.

Në Massachusetts, mosha ligjore e pëlqimit seksual është 16 vjeç, por marrëdhëniet seksuale me një person që është i paaftë për të dhënë pëlqimin për shkak të gjendjes së tij mund të përbëjnë vepër penale. Mendoza thotë se në atë kohë ishte shumë e frikësuar për t'i raportuar akuzat në polici dhe se e bëri këtë vetëm më vonë. Peters është përballur këtë muaj me akuza për përdhunim, drogim të një personi për qëllime seksuale dhe dhënie alkooli një të mituri. Akuza për përdhunim mund të dënohet me deri në 20 vite burg, nëse ai shpallet fajtor.

Përveç çështjes penale, Mendoza ka ngritur edhe një padi civile ndaj Peters në Miami-Dade County. Në padi ajo pretendon se të dy u takuan përsëri në Miami dhe se më vonë 20-vjeçari dyshohet se e detyroi të lejonte injektimin e faqeve të saj me një substancë që përdoret për shkrirjen e dhjamit. Sipas padisë, substanca e injektuar dyshohet se përmbante metamfetaminë dhe i shkaktoi dëmtime në fytyrë. Këto pretendime janë gjithashtu të pakonfirmuara në gjykatë.

Peters nuk i ka komentuar drejtpërdrejt akuzat, por në një postim në X ka shkruar se padia ishte një përpjekje për të tërhequr vëmendjen e tij dhe e ka cilësuar atë si "të vogël" dhe të parëndësishme. Avokati i tij, Steve Kramer, ka deklaruar se akuzat janë vetëm pretendime dhe se ato nuk janë provuar. Sipas tij, Peters i mohon pretendimet dhe kundërshton mënyrën se si janë përshkruar ngjarjet.

Avokati ka thënë gjithashtu se klienti i tij do të mbrohet përmes rrugëve ligjore. Peters pritet të dalë përpara gjykatës për seancën e parë më 14 tetor. Kush është Clavicular? Braden Peters është bërë i njohur në internet për përmbajtjen e tij të lidhur me "looksmaxxing", një trend online ku kryesisht të rinj përpiqen të ndryshojnë në mënyrë drastike pamjen e tyre fizike. Përmbajtja e Peters ka përfshirë edhe praktikën e njohur si "bone smashing", që konsiston në goditjen e përsëritur të fytyrës me mjete të forta me synimin për të ndryshuar formën e nofullës. Ai është akuzuar gjithashtu se ka promovuar metoda ekstreme për dobësim.

## LAJME TË NGJASHME




Foshnja e porsalindur humb jetën pas lindjes, 22 punonjës shëndetësorë nën hetim!

1 MIN



Eskursioni shkollor kthehet në tragjedi, vdes mësuesja dhe një nga nxënësit!

1 MIN



ZI në futbollin turk, shuhet në moshën 25-vjeçare Tolga Kalender!

1 MIN



U ngjit në shtyllën e tensionit të lartë për trendin e rrezikshëm/Vogëlushja goditet nga 30 mijë volt!

2.5 MIN



Italia ndalon burkën në shkolla/Kufizime edhe për nxënësit e huaj në klasa!

1.5 MIN

## MË TË LEXUARAT



Pse na mungon dikush më shumë gjatë natës? Ja çfarë mund të fshihet pas kësaj ndjesie…



GJKKO konfirmon masën e sigurisë për Vlora Hysenin!



Misteri i vdekjes së Maradonës merr kthesë të re, reagon eksperti dhe jep lajmin e hidhur!



U plagos pas konfliktit në Tiranë, një 49 vjeçar ndërroi jetë në spital!



4 suplemente që nuk duhet t'i merrni kurrë me ilaçet për tensionin e lartë!



"E kam nisur nga terreni, më pëlqen më shumë…"/Gazetarja Trevisa Tufa: Kur të jetë mundësia më e mirë në kohën e duhur…



Parkim me pagesë nga 5 tetori në Durrës, ja sa do të paguajnë qytetarët dhe çfarë përfitojnë rezidentët



Njihuni me ishullin ku derrat notojnë me turistët!



Ish-banorja e "BBV", Amber surprizon me transformimin e ri/FOTO!



Seriali kriminal që po çmend Netflix-in, 12.2 milionë shikime në vetëm katër ditë? Cili është?

## EDITORI SUGJERON



Kuqezinjtë nisin misionin e ri në Nations League, të gjitha emocionet live dhe ekskluzivisht në DigitAlb!



Pse na mungon dikush më shumë gjatë natës? Ja çfarë mund të fshihet pas kësaj ndjesie...



Mund t'u mungosh shumë, por mesazhin mos e prit! 3 shenjat e horoskopit që nuk bëjnë kurrë hapin e parë...



Fenomeni "pocketing"/ Kur partneri të mban sekret dhe askush në jetën e tij nuk e di që ekziston...



Pse disa njerëz ecin nëpër shtëpi ndërsa flasin në telefon? Arsyeja pse e bëjnë këtë pa e kuptuar është...



"Goca dhe Gra" rikthehet në ekranin e Top Channel me ndryshime, kush janë moderatoret e sezonit të ri?



"Vetëm 1.8 kg, dyditëshe dhe…"/ Prof. Dr. Altin Veshti zbulon operacionin e jashtëzakonshëm në zemër që ka kryer!



Kur duhet operuar zemra? Prof. Dr. Altin Veshti zbulon rastet kur stentet (unazat) nuk janë më zgjidhje për pacientin...




Kivi apo kumbullave të thata! Cila është më e mirë për tretjen?



"Kam operuar një 41-vjeçar me bypass…"/ Prof. Dr. Altin Veshti për infarktet: Mosha po ulet gjithmonë e më shumë!

**RRETH NESH**

Top Albania Radio promovon muzikën më të zgjedhur shqiptare dhe të huaj, me edicionet informative dhe një larmi programesh kulturore. 27 vjet transmetim, për të dhënë më të mirën.

**KONTAKT**

Address: Sheshi Italia 1, Arena Center, Tirana, Albania
Email:
[email protected]

Tel: +355 69 208 0500
+355 69 442 8873

**COPYRIGHTS**

Përmbajtja e këtij website është pronë e Top Albania Radio. Kopjimi, përdorimi apo riprodhimi i paautorizuar i tij, përbën shkelje penale.



JavaScript is required for tabnav widget to work properly.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.